

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI  
TË KUFIZUAR  
ALFA HOLDING Sh.p.k.**

- Znj.Fatime Kondaj, atësia Bejkush datëlindje 27.12.1972, lindur në Amonicë,Vlorë dhe banuese në Tiranë, Rr.Dashamir Fagu me karte identiteti ID nr.032939031 dhe nr.personal H26227064G.
- dhe
- Z. Axhibajram Lufi, atësia Rahmi datëlindje 31.05.1956, lindur në Veleshtë, Strugë, Maqedoni dhe banues në Tiranë, Rr.Dashamir Fagu, me karte identiteti ID nr.3105956434006 dhe nr.personal G1221009.

kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është **Alfa Holding Sh.p.k.**

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rr.Dashamir Fagu, Njesia Bashkiake Nr3, Nd.37, Hyrja Nr.1.


**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

- Investime në fushën e minierave të kromit, nxjerrje, prodhim eksport, përpunim, zbulim kërkim i mineraleve, etj. Investime në fushën e turizmit, menaxhim dhe hotelerit. Import eksport, tregtimi, transport i karburanteve dhe derivateve të tyre të tilla si naftë, benzine, karburantet e aviacionit, vajra, lubrifikante, solar, etj; të karburanteve dhe derivateve të tyre të tilla si naftë, benzine, vajra, lubrifikante, solar, etj; Import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë, transport i gazit të lengshëm (LPG) për automjete, përdorim familjar, dhe konsumator; Import, eksport, tregtim i veshjeve dhe produkteve që lidhen me industrinë e naftës; Ndërtimi dhe montimi i të gjitha mjeteve dhe pjesëve të kerkuara në operacionet hidrokarbure. Përdorimi, shitja, shkëmbimi, eksporti, nxjerrja dhe posedimi i naftës së prodhuar në zonat e miratuara në marrëveshjet hidrokarbure; Projektim, ndërtim, menaxhim i hidrocentraleve, kaskadave, impiante të energjisë së erës dhe impianteve të energjisë diellore; import -eksport, shpërndarje, tregtim dhe shitje të energjisë së erës, të energjisë diellore, të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe çdo energji tjetër të rinovueshme si dhe nënproduktet të tjera të burimeve të energjisë së rinovueshme, importim dhe eksportim i mjeteve motorrike dhe perfaqesimit të furnizuesit dhe prodhuesit. Tregti me pakicë produkte ari dhe argjendi. Import, eksport, tregu me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm industriale, ushqimore, artikuj bujqësorë e blegtoralë; Të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme si dhe çdo aktivitet tregtar, të vendosë pengje ose barre hipotekore, etj. Security. Kancelari.



### Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakeve në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

### Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Znj. Fatime Kondaj, atësia Bejkush datëlindje 27.12.1972, të cilit i përket 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 50,000 lekë që i korespondon 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- Z. Axhibajram Lufi, atësia Rami datëlindje 31.05.1956, të cilit i përket 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 50,000 lekë që i korespondon 50% të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

### Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Znj. Fatime Kondaj, atësia Bejkush datëlindje 27.12.1972, lindur në Amonicë, Vlorë dhe banuese në Tiranë, Rr. Dashamir Fagu me kartë identiteti ID nr. 032939031 dhe nr. personal H26227064G, emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

### Neni 9- Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.


### Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKËT  
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
Alfa Holding Sh.p.k

Adjibabajram Rahmi Lufi



Data: 04.04.2024

Fatime Bejkush Kondaj

